



## **Analizë e raporteve vjetore**

**08/2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

## Analizë e Raportit Vjetor të KOSTT-it

---

*“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”*

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	4
Baza ligjore.....	5
Organizmi institucional.....	5
Përshkrim i tregut/fushës që e mbulon institucioni.....	6
Përfundime.....	10

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2016. Puna e INDEP është mbështetur në parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe hulumtimit të pavarur.

Në vitin 2016, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ishte përballur me një dilemë në vendimmarrje. Në komentet që Sekretariati i Komitetit të Energjisë kishte dërguar për, në atë kohë draftin e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, kërkohej medoemos që bordin e prodhuesit (KEK-ut) dhe operatorit të transmisionit (KOSTT) të mos e zgjedhë organi i njëjtë institucional (Qeveria). E gjitha kjo për të mbështetur parimet e liberalizimit të tregut dhe ofrimit të kushteve për një konkurrencë sa më të drejtë në treg.

Duke qenë në fazën e shqyrtimit në Kuvend dhe me kohën që nuk ishte e mjaftueshme, Komisioni ndërroi disa dispozita duke ia kaluar pronësinë e KOSTT Kuvendit të Republikës së Kosovës por jo edhe duke i ndërruar statusin e ndërmarrjes publike. Edhe pse për nga natyra Operatori i Tregut dhe Transmisionit kryen një shërbim publik, që është karakteristikë e ndërmarrjeve publike, kalimi i pronësisë së ndërmarrjeve publike tek Kuvendi i Republikës për INDEP ishte një veprim që mund të nxiste dilema kushtetuese.

Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. **Qeveria e Kosovës** mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.<sup>1</sup>

Megjithatë, duke qenë kërkesë e procesit të integritetit dhe implementimit të qëllimeve të *pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë*, Kuvendi pranoi që një ndërmarrje publike të vepronte në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike por zgjedhja e bordit, pronësia dhe raportimi ti kalojnë Kuvendit. Kështu, ky është raporti i parë që Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e merr nga KOSTT.

Duke u bazuar në Manualin për Raportim të Agjencive të Pavarura, një dokument i hartuar me iniciativën e Komisionit në vitin 2014 dhe i cili është shpërndarë tek të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit të Kosovës, raporti i KOSTT i përmbahet pjesërisht këtij manuali si strukturë, dhe ofron një mori të dhënash rreth funksionimit të KOSTT, tregut dhe operatorëve të tij, bazës ligjore dhe sfidave për të ardhmen.

Sa i përket bazës ligjore, KOSTT raporton se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Energjinë Elektrike në gusht të vitit 2016 Ligji Nr. 05/L-085, të drejtat e aksionarit për ndërmarrjen publike KOSTT sh.a. ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, KOSTT vazhdon të operoj si ndërmarrje publike e organizuar në formën ligjore të shoqërisë aksionare, dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike vazhdon të aplikohet për të gjitha çështjet të cilat ndërlidhen me veprimtarinë e KOSTT. Kompetencat për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit,

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, (2008), Neni 160, Ndërmarrjet në Pronësi Publike, paragrafi 1, faqe 65, Prishtinë: GZRKS.

kompensimin e Bordit të Drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlejnë pasi që të gjitha këto kompetenca ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës.

KOSTT operon në mes të një treg relativisht kompleks të energjisë elektrike, që nga prodhuesi, me KEK-un si prodhuesin kryesor deri tek furnizuesi kryesor KES|CO. Kësisoj, me raportimin vjetor ka mundësi që një pjesë e madhe e shqetësimeve që kanë të bëjnë me funksionimin e njërit prej akterëve më të rëndësishëm të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.



Figura 1. Akterët kryesor në tregun e energjisë elektrike në Kosovë<sup>2</sup>

## Baza ligjore

Në pjesën e raportimit për bazën ligjore, KOSTT ka listuar bazën ekzistuese ligjore. Nga leximi i raportit është e qartë korniza e përgjithshme ligjore. Megjithatë, në të kaluarën, nga institucionet që i raportojnë Kuvendit, është pritur më tepër sesa listim i bazës ligjore. KOSTT në raport do të duhej të tregonte se a ka nevojë për ndryshim në legjislacionin ekzistues, a ka vështirësi që hasen në kornizën aktuale ligjore. Për më tepër do të duhej të raportonte se si ka ndikuar procesi i shthurjes pronësore të KOSTT-it, pra ndarja e operatorit të transmisionit dhe operatorit të tregut si dhe të raportonte ndikimin e procesit ku të drejtat e aksionarit nga qeveria i kalojnë Kuvendit të Kosovës, dhe se a ka ndikuar në funksionimin e gjithëmbarshtëm të ndërmarrjes.

Kjo do të ishte veçanërisht e rëndësishme marrë parasysh faktin se me datë 07/11/2017 në mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal u formua nën komisioni për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Energji Elektrike Ligji Nr. 05/L-085. Për këtë nënkomision, do të ishte shumë ndihmues një raportim paraprak i KOSTT në lidhje me statusin e zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Ky ligj, është në fazën fillestare të ciklit të zbatimit dhe është tejet e rëndësishme që Komisioni, përmes raportit vjetor, të marrë një qëndrim të KOSTT në lidhje me zbatueshmërinë e tij.

## Organizmi institucional

Organizmi institucional i KOSTT është raportuar pjesërisht në përputhje me standardet e raportimit dhe kërkesat për raportim në Kuvendin e Kosovës. Sa i përket bordit, raporti përmban të dhënat për përbërjen e tij, mirëpo nuk ka të dhëna rreth mandatit të anëtarëve të bordit dhe kohën se kur u skadon ky mandat. Po ashtu edhe tek ekzekutivi përveç të dhënave për përbërjen e menaxhmentit të lartë nuk ka ndonjë të dhënë për menaxhmentin e mesëm, e po ashtu nuk përmban të dhëna rreth mandatit të ekzekutivit dhe kohën kur i skadon mandati.

Në raport KOSTT tregon numrin e punëtorëve si dhe sqaron lëvizjen e numrit të punëtorëve nga 349 i cili ishte në janar të vitit 2016 në 360 punëtor në dhjetor të vitit 2016, rritje kjo e cila ka ndodhë për shkak të pensionimit të punëtorëve si dhe të pranimit të punëtorëve të rinj. Rritja me

<sup>2</sup> Ahmetaj, Gent, Ejupi, Burim, Gojani, Rinora, (2015), Mundësitë e Kosovës për një treg të energjisë: rasti i energjisë elektrike, Prishtinë: INDEP.

arsyetim pensionimin, do të duhej të sqarohet më hollësisht sepse një shpjegim logjik do të nënkuptonte se në janar ka pasur numër më të vogël të punonjësve për arsye se një pjesë e tyre janë pensionuar dhe ndërkohë gjatë vitit ka ndodhur plotësimi i vendeve të punës që jo domosdoshmërisht do të thotë rritje nga viti i kaluar. Kjo megjithatë, nuk është sqaruar më gjatë. Në anën tjetër, në raportin e KOSTT nuk përmendet nëse ka nevojë për më shumë personel.

Ky raport përmban pjesën e trajnimit të personelit, por nuk jep tabelën e specifikuar të trajnimeve, por vetëm tregon se janë trajnuar nga Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit 321 punëtorë apo gjithsej 658 orë trajnim. Po ashtu, është e rëndësishme të pasqyrohet edhe ndikimi i këtyre trajnimeve në përmirësimin e performancës së stafit apo edhe në arritjen e objektivave strategjike, pasi që përfundimisht, trajnimi i punonjësve realizohet me qëllim të arritjes së objektivave. Këtë, ky raport nuk e ka ofruar.

Në raport është e përfshirë një pjesë e asetëve që ka në posedim KOSTT si dhe asetet të cilat kanë kaluar nga KEK në KOSTT. është raportuar transferimi i asteve si NS 110/x kV ku në raport thuhet se mbetet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kurfirin e ri i cili do të funksionalizohet hap pas hapi. INDEP vlerëson se kjo procedurë e kontrollit dhe funksionalizimit do të duhej të paraqitej në një afat kohor, për shkak se një paraqitje në një afat kohorë do të pasqyroste më detajisht objektivat që ka KOSTT për zgjerimin e kontrollit të plotë mbi asetet e veta. Po ashtu, INDEP vlerëson se në raport do të duhej të paraqitej një afat se deri kur KOSTT parashikon përmirësimin e asetëve të transferuara nga KEK, pasi që ndër rreziqet e identifikuar të cilat paraqesin kërcënim në zvogëlimin e performancës së furnizimit dhe kostot shtesë të zhvillimit është edhe gjendja e asetëve të transferuara nga KEK-u. Përveç tjerash në aneks të raportit KOSTT do të duhej të pasqyroste listën e të gjitha asetëve që ka në pronësi, listë kjo e cila mungon.

## **Përshkrim i tregut/fushës që e mbulon institucioni**

Në përgjithësi, ky raport ofron informata të shumta. Megjithatë, mungon një kohezion i tyre. Në raport me Kuvendin e Republikës, do të duhej të raportonte në një frymë kohezive. Në raport vërehet që ka bashkim copëzash të raportit të bordit dhe menaxhmentit. Raportimi i segmentuar mund të krijojë konfuzion tek deputetët. Nevojitet një raportim unik dhe një zë i vetëm i përshkrimit të arritjeve dhe sfidave.

**KOSTT është operatori i transmisionit me humbjet më të vogla teknike në rajon dhe INDEP vlerëson që kjo e arritur duhet njohur dhe vlerësuar.**

Në pjesën e operimit të tregut mungojnë të dhëna krahasuese me vitet e tjera. Është viti i parë që Kuvendi merr raport të veçantë nga KOSTT. Paraqitja e rezultateve në projeksion krahasues do të ishte tejet ndihmues për të krijuar një pasqyrë më të qartë.

Në raport KOSTT ka përfshirë projektet të cilat janë të paraqitura në planin zhvillimor të transimisionit nga ku shihet se një numër jo i vogël i projekteve nuk ka arritur të përfundojë sipas planifikimit për vitin 2016.

Tabela në vazhdim ka listuar këto projekte për të cilat nuk janë sqaruar arsyet e vonesave:

Emri i projektit	Përshkrimi teknik	Objektivat	Planifikimi sipas Planit Zhvillimor	Në raport thuhet vetëm:
<b>Ri-vitalizimi i linjës 110 kV: L126/2 NS Peja 2- NS Deçan</b>	(a) Ndërrimi i përçuesit nga 150/25mm <sup>2</sup> në 240/40mm <sup>2</sup> në gjatësinë 14.57 km nga NS Peja 2 deri në NS Deçan (b) Përforcim i shtyllave të betonit si dhe ndërrimi i izolatorëve ekzistues me izolator kompozit.	Rritja e kapacitetit transmetues të linjës nga 83 MVA në 114 MVA me qëllim të reduktimit të humbjeve të fuqisë, përmirësimit të kriterit të sigurisë N-1 për unazën e nënstacioneve 110 kV Peja3-Peja1-Peja2-Deçan – Gjakova1.	Q4- 2016	<i>Pritet fillimi i punëve në fillim të vitit 2017</i>
<b>Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4</b>	a) Ndërrimi i ndërprerësve të fuqisë 110 kV dhe 220 kV përveç dy fushave të ATR3	Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të nënstacionit	Q4-2016	<i>73% e punëve janë kompletuar</i>
<b>Implementimi i ndryshimeve dhe inkorporimi i tyre ne SCADA/EMS</b>	a)Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe b) inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispečerike dhe në Qendrën Emergjente Dispečerike	Shfrytëzimi optimal i sistemit SCADA/EMS	Q4-2016	<i>Statusi i projektit : Projekti është në fazën e implementimit është zgjatur afati i implementimit</i>
<b>Linja e re 110 kV NS Peja 3- NS Peja 1 dhe ri-vitalizimi i NS Peja 1</b>	a) 28 km, Al.Çe240mm <sup>2</sup> ; b) Fusha e linjës në NS Peja 3; c) Rivitalizimi i NS Peja 1 i pajisjeve dhe sistemit te zbarave ne	Ndërtimi i linjës mundëson plotësimin e kriterit N-1. Gjithashtu rivitalizimi i NS Peja 1 ndikon ne rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë se operimit te sistemit.	Q4-2016	<i>Data e kompletimit 2018</i>

	nivelin 110 kV, duke kaluar ne sistem te zbarave te dyfishta dhe ne sistem GIS te pajisjeve 110 kV.			
<b>Ri-vitalizimi i linjës 110 kV: L126/2 NS Peja 2- NS Deçan</b>	(a) Ndërrimi i përçuesit nga 150/25mm <sup>2</sup> në 240/40mm <sup>2</sup> në gjatësinë 14.57 km nga NS Peja 2 deri në NS Deçan (b) Përforcim i shtyllave të betonit si dhe ndërrimi i izolatorëve ekzistues me izolator kompozit.	Rritja e kapacitetit transmetues të linjës nga 83 MVA në 114 MVA me qëllim të reduktimit të humbjeve të fuqisë, përmirësimit të kriterit të sigurisë N-1 për unazën e nënstacioneve 110 kV Peja3-Peja1-Peja2-Deçan – Gjakova1.	Q4-2016	<i>Data e kompletimit 2018</i>
<b>AT2-300 MVA në NS PEJA3 dhe NS FERIZAJ 2</b>	(a) Auto-transformator 300 MVA, 400/110 kV; (b) Instalimi i pajisjeve të tensionit të lartë për fushat transformatorik e 400 kV dhe 110 kV	Rritja e kapaciteteve të transformimit dhe plotësimi i kriterit të sigurisë N-1.	Q4-2016	<i>Data e kompletimit 2018</i>
<b>INSTALIMI I OPGW në linjat interkonektive 400 kV -</b> Instalimi i rrugëve telekomunikues e përmes OPGW në linjat interkonektive	a)Përçuesi mbrojtës ekzistues 65mm <sup>2</sup> në 400 kV deri në kufij me vendet fqinje do të ndërrohet me përçues mbrojtës me të njëjtat dimensione me	Plotësimi i kërkesave teknike qe dalin nga doracaku i ENTSO/E	Q3-2016	<i>Data e kompletimit 2018</i>



400 kV dhe 220 kV deri ne kufij.	përmbajtje te 96 fijeve optike.			
<b>INTER-OST Njehsorët</b> (- Instalimi i pikave matëse në linjat ndërkufitare ne pajtueshmëri me kodin e matjes	(a) Instalimi i transformatorëve e matës me nga dy bërthama për matje komerciale me karakteristika të njëjta në linjat e interkoneksioni t 400 kV, 220 kV dhe 110 kV (b) Ndërrimi i njehsorëve ekzistues me njehsor ne pajtueshmëri me Kodin e Matjes	Projekti do të mundësoj kompletimin e instalimit të njehsorëve në kufij në pajtueshmëri me Kodin e Matjes.	Q4-2016	<i>Data e kompletimit 2018</i>
<b>Transformatori i i dytë 40 MVA ne NS Klinë</b>	a) Transformator TR2 110/10(20) kV, 40 MVA b) 1 fushë transformatorik e 110 kV dhe 10(20) kV e kompletuar	Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë se furnizimit te Klina. Optimizimi i procesit te mirembajtjes se Nenstacionit. Krijimi i rezervave transformuese.	Q2-2016	<i>S'ka raportim</i>

## Përfundime

- Raporti i KOSTT për Kuvendin e Kosovës përgjithësisht përmban informata të shumta por i mungon një organizim dhe frymë koherente. Vërehet që është raportuar pjesë pjesë dhe nuk është shkruar nga një zë i vetëm. Për Kuvendin e Republikës së Kosovës, raporti është i KOSTT-it si i tërë, dhe jo i departamenteve, bordit apo organeve të tjera të brendshme. Manuali për Raportim të Agjencive të Pavarura i Kuvendit është respektuar pjesërisht.
- KOSTT nuk ka ofruar informata të bollshme sa i përket bazës ligjore dhe sa i takon të dhënave mbi personalin dhe resurseve humane. Nën dritën e monitorimit të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, një vlerësim nga KOSTT në lidhje se sa është e zbatueshme baza aktuale ligjore mungon. Raporti nuk ka sqaruar hollësisht strukturën e tanishme të stafit, trajnimet dhe nevojat për të ardhmen. Një analizë më e hollësishme në këtë fushë është e nevojshme duke pasur parasysh që Komisioni mund të intervenojë edhe në fazat e miratimit të buxhetit që të kërkoj alokim të mjeteve për nevoja të institucionit.
- Gjuha e përdorur në raport shpesh i ngjanë gjuhës së komunikimit të brendshëm të institucionit. INDEP vlerëson që për deputetët është e domosdoshme një gjuhë më e thjeshtë dhe ndërlidhje e aktiviteteve me afate kohore dhe rezultate konkrete në kuptim të mirëfunksionimit të tregut. Rasti i raportimit të kalimit të aseteve nga KEK në KOSTT është më reprezentuesi i qasjes shumë teknike dhe jo sqaruese sa duhet.
- Ka pasur shtyerje të implementimit të një pjese të konsiderueshme të projekteve investuese. Ne kemi krahasuar projektet në “Planin Zhvillimor të Operatorit të Sistemit të Transmisionit” me raportimin që është dhënë dhe për një pjesë të konsiderueshme është raportuar vonesë në implementim por nuk janë sqaruar arsyet. Është e domosdoshme që për secilën të jepen arsyet e vonesave qoftë në fillim, qoftë në përfundim të projekteve.
- KOSTT duhet të punoj më shumë në reprezentimin e sukseseve. Është operatori me humbjet më të vogla teknike në rajon dhe kjo do të duhej të ishte më e dukshme në raport. Marrë në tërësi, duke marrë parasysh faktin që kanë kaluar nga një formë krejtësisht tjetër e raportimit, tek raportimi në Kuvendin e Kosovës, KOSTT në masë të madhe ka arritur të përmbushë kërkesat për një raportim të drejtë dhe informues.

---

*“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicrane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.*